

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 802 Prot.

Tiranë, më 26/09/2023

VENDIM

Nr. 37, DATË 26/09/2023

MBI

**“MIRATIMIN E PUNËSIMIT TË 1 (NJË) PUNONJËSI MËSIMOR (PERSONALITET)
NË FM, PRANË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, ME KONTRATË ME
KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ANGAZHIM ME KOHË TË PLOTË
MËSIMORE, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 (Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë), neni 38 (Funkcionet e Senatit Akademik), neni 62 (Personeli akademik i ftuar), të Statutit të UART, neni 58, pika 3, bazuar në kërkesën e FM bashkëlidhur vendimit, pas diskutimeve, Senati Akademik në mënyrë unanime dhe me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Fakultetit të Muzikës, për punësimin e **Dr. Suzana TURKU**, si punonjës me kontratë (Personalitet), për vitin akademik 2023-2024.
2. Ky vendim të shoqërohet në Bordin e Administrimit për miratim.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI I KANTOS

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 20.09.2023

Lënda: Kërkesë për punësim personeli akademik me kontratë për vitin akademik 2023-2024

Drejtuar : Prof. Dr. Isak Shehu
Dekan i Fakultetit të Muzikës

Për dijëni : Prof. Kastriot ÇAUSHI
Rektor i Universitet të Arteve

I nderuar zoti Dekan,

Në programet e studimit të Departamentit të Kantos, Klasë Korale dhe Klasë Opere, lëndë që prej vitesh zhvillohen nga pedagogë të jashtëm, por që kanë një peshë specifike tq qënësishme në planet mësimore të të dy cikleve (Bachelor e Master) të Departamentit tonë.

Ngarkesa e lëndëve të sipërpërmendura duke shtuar dhe lëndën special të Dirizhimit Koral, për një studente, arrin në 210 orë.

Nisur nga mësipër ne propozojmë të marrim një personel akademik me kontratë 1 (një vjeçare). Këtë kërkesë e bazojmë në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë pika 1 që shprehet se “Njësitë Bazë të Institucioneve të Arsimit të Lartë kanë të drejtë të kërkojnë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj”.

Për mbi 16 vjet kemi angazhuar në këto lëndë pedagogen e ftuar , Artisten e Merituar, Dr. Suzana Turku, e njohur si personalitet në fushën e Dirizhimit Koral, e cila ka kryer me profesionalizëm dhe seriozitet mësimin në këto programe, duke realizuar me shumë sukses, vepra të njohura botërore, si “Karmina Burana” Fantazia e Beethoven për kor piano solistë e orkestër, opera të plota si “Cosi fan tutte”, “Mrika”, “Dido e Enea” e të tjera.

Duke u bazuar në vlerësimet e kësaj vlerësimi të studentëve, të kësaj fakulteti të
përkushtimin në punën e saj, mendojmë se dirigjentja Suzana Turku është një personaliteti I
fushës dhe do të shërbejë rritjes cilësore të mësimdhënies dhe përgatitjes së studentëve tanë.
Kjo gjë është në përputhje me politikën e departamentit të kësaj fakulteti në rekrutimin e
personaliteteve të veçanta në fushat përkatëse.

Pra kërkojmë që kërkesa jonë të merret në konsideratë, në dobi të rritjes cilësore të
procesit mësimor dhe në të mirën e studentëve të Fakultetit të Muzikës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin e vazhdueshëm.

Prof. Asoc. Dr. Kastriot Tusha

Përgjegjës i Njesisë Bazë Kanto



Kërkesë

Drejtuar:

Rektorit të UART, Prof. Kastriot Çausi.

Dekanit të Fakultetit të Muzikës, Prof. Dr. Isak Shehu.

Departamentit të Kantos, Prof. As, Dr. Kastriot Tusha.

Të nderuar drejtues të UART.

Unë, Suzana Turku, Dirigjente, kam një bashkëpunim shumë vjeçar me UART dhe veçanërisht me Fakultetin e Muzikës si pedagoge e ftuar në lëndët kolektive Klasë Opera, Klasë Korale dhe individuale Dirizhim Korale. Bashkëpunimi ynë ka qënë shumë i mire duke i dhënë shkollës shfaqje operistike dhe koncerte te ndryshme në vite.


Unë si pedagoge, dirigjente me përvojën time 45-vjeçare, jam munduar dhe kam punuar me shumë përkushtim me studentët për të realizuar vepra të epokave të ndryshme me nivel e cilësi të lartë profesionale, me qëllim që studentët ndër vite të kenë njohuritë dhe eksperiencën e duhur të shfaqjeve operistike dhe korale. Klasa e Operas dhe Klasa Korale përmbledhin pothuajse të gjithë studentët e Degës së Kantos: kompozicion, pedagogji, dirizhim, kitarë dhe instrumentistë.

Për këto arsye dhe në këto kushte, do të kërkoja nga ju të më jepet mundësia që gjatë këtij viti të punësohem si pedagog i ftuar me kontratë pranë Fakultetit të Muzikës.

Bashkëngjitur me kërkesën po ju nis dhe CV time.

Ju faleminderit!

Me respekt
Dr. Suzana Turku



Dirigjente

Pioneri ne Shkoder, festivali kengesht ne Tirane dhe ne shume koncerte. Emri i saj u be i njohur me kengët: Topi im, Biçikleta, Kënga e nënës, Bie zilja etj.

Sukseset e saja dhe përvoja që fitoi në Pallatin e Pionerëve, i mundësuan pranimin si nxënëse në Liceun Artistik "Jordan Misja", ku ajo studion gjatë viteve 1968-1972 për teori muzike dhe kanto.

Pas përfundimit të Liceut Artistik, me rezultate shumë të mira, gjatë viteve 1972-1976, ajo vijoi studimet në Institutin e Artit të Arteve (sot Universiteti i Arteve) për Kritikë muzike dhe Dirigjim.

Diplomën e mbrojti me rezultate të shkëlqyera më 10 prill 1977, në sallën e Teatrit të Operas, duke dirigjuar një koncert të plotë me korin, solistet dhe orkestrën e TOB.

Në vitin 1976 emërohet në shkollën e mesme artistike Jordan Misja ku jep dirigjim, solfezh dhe klasë korale. Aty punoi si dirigjente e korit të vajzave, me të cilin fillon dhe realizimi i ëndrrës dhe dëshirës së saj, për t'u bërë dirigjente kori profesioniste. Nën dejtimin e saj, ky kor ka interpretuar muzikën *accapela* dhe muzikën korale të shoqëruar nga orkestra të ndryshme shqiptare. Me këtë kor lidhen dhe sukseset e para të aktivizimit të Suzana Turkut si dirigjente kori, me të cilin ajo ka organizuar koncerte të shumta në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Akademinë e Arteve, Teatrin e Operas dhe në qytete të ndryshme të Shqipërisë nga viti 1976-1983. Në ato vite, ky kor kishte arritur një nivel shumë të lartë interpretimi në përpunimet e këngëve popullore për kor vajzash, si dhe krijimet e kompozitorëve shqiptarë, të shkruara posaçërisht, si vepra premiere të personaliteteve të artit shqiptar: ÇeskZadeja, Feim Ibrahim, Limoz Dizdari, Tonin Harapi, Nikolla Zoraqi etj.

Me korin e Liceut Artistik janë regjistruar shumë korale në Radio-Tirana dhe emisione televizive, si dhe janë regjistruar koralet e shumë filmave të ndryshëm shqiptarë. Ky kor është vlersuar me çmime të para për vite me radhë (1977-1983); në koncertet e majit, po ashtu Zana vlersohet me çmime dhe me korin e pallatit të pionereve dhe me koret amatore të Tiranës.

Gjatë kësaj periudhe jep një kontribut në edukimin muzikor të fëmijëve nëpërmjet ciklit të emisionit televiziv "Të mësojmë këngën".

Në vitin 1983 emërohet dirigjente, mjeshtre e korit në TKOB. Gjatë viteve të punës së bashku me korin, u arrit një perfeksionim i disiplinës artistike, e cila sigurisht solli dhe ngritjen e nivelit interpretues.

Me këtë trupë korale ajo realizoi pothuajse të gjithë repertorin e koncerteve dhe veprave skenike të shfaqura nga Teatri i Operas gjatë viteve 1983-2000, të cilat u realizuan edhe në bashkëpunim të ngushtë me Mjeshtrat shqiptarë dirigjentë të Orkestrës së Operas si: R. Teqja, M. Krantja, E. Krantja, B. LLapaj. Mjaft i suksesshëm ka qenë bashkëpunimi me dirigjentët e huaj si: Jusuf El Sisi, Koiçi Inue, Sergio la Stella, Doron Solomon, Fabio Pirrone etj. Vlen të përmendim edhe bashkëpunimin e suksesshëm me regjisorë të ndryshëm italianë, austriakë dhe me këngëtarë e solistë nga vende të ndryshme të botës. Me arritjet e tyre, kori e Zana u bënë të njohur edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Mbas shumë vitesh, Zana guxoi përsëri. Këtë herë, me interpretimin e pjesëve në gjuhën origjinale, (latinisht, Italisht, Frengjisht, Gjermanisht) sepse deri në atë kohë gjithçka

Korale të Francës dhe Korit të Operas së Baslijës, të cilat pasuan me specializime me SIDA, Slloveni, Gjermani, Austri, Rumani, Greqi, Norvegji, etj.

Në repertorin e Trupës së Korit të Operas, nën drejtimin e Zana Turkut, përfshihen veprat vokale, operistike, koncertale shqiptare, si dhe veprat operistike që TOB ka vënë në skenë që prej vitit 1983 derinë 2000 si: *Traviata*, *Rigoletto*, *Trovatore*, *Aida*, *Otello* (Verdi), *Boheme*, *Manon Lescaut*, *Tosca*, (Pucini), *Berberi i Sevilyes*, *Gazza ladra* (Rossini), *Così fan tutte*, *Don Giovanni*, (Mozart), *Pagliaci* (Leoncavallo), *Peshkatarët e perlave*, *Carmen* (Bizet), *Norma*, (Belini), *Cavaleria Rusticana* (Mascagni), *Maleve për liri* (Leka), *Paja* (Zoraqi), *Zgjimi*, (Tonin Harapi), *Princesha e Cardashit*, *Mrika*, (rivënie Jakova), Korale të nga baletit *Joniada* (Zoraqi), në vitin 2004 *Turandotet* (Puccini), Operat *Aida* (2006), *Lucia di Lamermour* (2008), *Manon Lescaut* (2010). *Borana*, *Karnavalet e Korces*, *Nena e Trimave*, (Avni Mula).

Të gjitha veprat e mëdha vokale koncertale për kor dhe orkestër të autorëve shqiptarë, si dhe kryeveprat korale botërore, "Requiem" Mozart, Brahms, Faures, "Carmina Burana" Carl Orff, "Stabat mater" Rossini, "Messia" Mendel, "Simfonia 9" Bethoven, "Requiem" Tonin Harapi, "Theodelinda" Angelo Bellisario, "Psalmi 95" Mendelson, janë realizuar nga dirigjentja Z. Turku.

Në vitin 1988, në bashkëpunim me kompozitorin, mikun e saj, Gjon Simoni, ajo punon për realizimin për herë të parë në Shqipëri të një koncerti me muzikë simfo-xhaz, me korin e Operas dhe me formacionin instrumental të RTSH.

Me korin e Operas, Zana ka një numër të madh koncertesh recital në skenën e TOB dhe në festivale ndërkombetare në Itali. Si dhe shumë regjistrime dhe inçizime në RTSH.

Referenca

-Me shumë kënaqësi kam dirigjuar operën "Turandot" të G. Puccini-t, në vitin 2005, në TOB-it në Tiranë. Me atë rast munda të vlerësoja përgatitjen kompetente të korit, të realizuar nga Mjeshtrja Zana Turku. Mjeshtrja Turku demostroi një dirigjente kori shumë të përgatitur, kompetente dhe një bashkëpunëtare muzikante.

Ajo mund të jetë dirigjente kori në shumë teatro të Europës. Shpresoj të ribashkëpunoj me mjeshtrën Turku, e cila përveç përgatitjes muzikore, bashkon në një vitalitetin dhe simpatinë njerëzore.

Fabio Pirona

Dirigjent (Itali)

Tiranë, 4 Tetor 2008

- Ka qenë një nder që mu dha rasti të bashkëpunoj me znj. Suzana Turku, një profesioniste e jashtëzakonshme, e aftë për të dhënë një ngjyrë dhe një stil të mahnitshëm trupës korale. Do ta kujtoj këtë "Lucie e Lamermurit" edhe për punën e saj të mrekullueshme.

një artiste femër me arritje të tilla, që i japin asaj të drejtën e përfaqësimit të një kulmi në artin e dirigjimit koral shqiptar të ditëve tona.

Në vitin 1993, ajo krijoi grupin koral "Pax Dei", që me aktivitetin e tij koncertal u bë i njohur në Shqipëri dhe jashtë saj, CeskZadeja do të shprehej: *Vlerat dhe roli i ansamblit vokal "PAX DEI", i themeluar nga dirigjentja e talentuar Suzana Turku me përkushtim dhe ndërgjegje të lartë, po shpalos më tej traditat e muzikë svokale.*

Ky kor ka dhënë koncerte të sukseshme në Greqi, Gjermani, Itali, Zvicër, Maqedoni, Kosovë dhe pjesmarrës në disa festivale ndërkombetare. Me këtë kor janë realizuar edhe vepra premierë si: "Magnificat" Bach, "Magnificat" Vivaldi, "Gloria" Vivaldi, "Mesha e Kurorzimit" Mozart, "Messa in Sol" "Messa in Fa" Schubert, "Te Deum" Hayden, dhe shumë pjesë accappella të autorëve të ndryshëm paraklasikë, klasikë e modern.

Ky kor krijoi traditën e koncerteve për krishtlindje në Shqipëri që nga viti 1993.

Në harkun e viteve 2000 ajo drejton klasën korale dhe dirigjimin koral në Akademinë e Arteve dhe realizon vepra të plota si opera "Dido dhe Enea", Purcell, "Orfeu", Gluck, "Stabat Mater" Pergolesi, "Scanderbeg" F. Franceur, Faure "Requiem". Belini, korale nga operat "Sonambula" dhe "Norma", Vivaldi "Magnificat".

Në vitin 2002 krijon korin e vajzave Gjon Simoni dhe korin e fëmijëve Engjejt e Vegjël.

Nga viti 2005 deri në vitin 2013 jep kontributin e saj në zhvillimin dhe njohjen e kultures Shqiptare në një post të lartë drejtues. Gjatë kësaj periudhe duke pëmbushur me përkushtim të gjitha detyrat e postit që mbante, ajo, vazhdoi edhe jetën koncertale, mbrënda dhe jashtë vendit.

Nga viti 2013 vazhdon dirigjente pranë Universitetit të Arteve, ku drejton klasen e operas dhe klasën korale, me të njëjtin përkushtim dhe pasion. Njohuritë dhe përvojën e saj përpiqet t'ia transmetojë studentëve, duke vendosur mardhënie të drejta profesionale dhe njerëzore. Gjatë edukimit artistik në këto dy lëndë të rëndësishme në formimin dhe edukimin artistik të të rinjve, së bashku me kolegët e mirenjohur, profesorë të Fakultetit të Muzikës, kanë evidentuar dhe aktivizuar, shumë talente të rinj, me të cilët janë realizuar vepra të plota, operistike dhe vokale dhe shumë koncerte brënda dhe jashtë vendit. Vetëm me studentët pjesëmarrës janë realizuar

ndryshëm. Në realizimin e veprave me studentët ka pasur një nivel artistik të shkëlqyer, në bashkpunim edhe me dirigjentë të huaj. Kori i studentëve tashmë është pjesëmarrës në shumë aktivitete koncertale kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë gjithë aktivitetit të saj, artistik dhe kulturor, ajo, ka marrë pjesë në shumë takime, konferenca, simpoziume, kombëtare dhe ndërkombëtare duke shkëmbyer përvoja, trajtuar tema në lidhje me artin e dirigjimit koral, me trashgiminë kulturore, ku ajo ka referuar tema për ruajtjen e trashgimisë sonë shpirtërore duke bërë të njohur në nivele dhe institucione të larta vlerat dhe pasurinë e jashtëzakonshme të artit shqiptar. Ka luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e urave lidhëse të bashkpunimit midis kultures shqiptare dhe të vendeve të tjera.

Dirigjentja Suzana Turku, ka një kontribut të rëndësishëm në regjistrimin audio të muzikës shqiptaresi: 2 CD me korin Pax Dei, 2 Cd me këngë patriotike me korin e burrave, 1 CD me korin e fëmijëve “Engjëjt e vegjël”. 1 CD me korin dhe orkestrën Nënë Tereza.

Kontributi i saj është edhe në botimin e librit “Pjesë të zgjedhura korale” nga kompozitorët shqiptarë. Ajo vazhdon me përkushtimin që e karakterizon dhe me profesionalizëm, punën e saj për edukimin e brezit të ri të artistëve dhe jetën koncertale.

Mban Titullin “Artiste Merituar” - (1989)

Doktor Shkencash “në fushën e etnomuzikologjisë” - (2013)

Antare e “Europa Cantat” - 1994

Antare e “IFCM” - 2001

Antare e Bordit Drejtues të “koreve olimpike–2008

Magistra Chori “Honorary Title” – 2012